



Australian Government
Inspector-General of Taxation
Taxation Ombudsman

Ankesë Tatimore?



Albanian

Kush Jemi Ne

Inspektoriati i Përgjithshëm & Avokati i Popullit për Tatimet (The Inspector-General & Taxation Ombudsman - IGTO) është një agjenci e pavarur e Qeverisë Federale, përgjegjëse për t'ju ndihmuar me ankesat tuaja që mund të keni ndaj Zyrës Australiane të Tatimeve (Australian Taxation Office - ATO) dhe veprimeve administrative ndaj Bordit të Specialistëve të Tatimeve. (Tax Practitioners Board - TPB).



1300 44 88 29
(tarifa për thirje lokale)

Si mund t'ju ndihmojmë

Për t'ju ndihmuar me ankesën tuaj, ne ju ofrojmë një shërbim falas, independent dhe të specializuar në fushën e Tatimeve.

‘Veprim Administrativ’ është një term i gjërë i cili përfshin përgjithësisht pa-anësi, drejtësi dhe arsyeshmëri në mardhëniet tuaja dhe zyrës së ATO apo TPB gjatë bisedimeve tuaja.

Shëmbuj ku IGTÖ mund t'ju ndihmojë, përfshin, por nuk kufizohet në:

- Afati kohor i përgjigjeve ndaj kërkesave tuaja;
- sjellja e zyrtarëve të ATO ose TPB;
- disponueshmëria e shërbimeve online;
- sigurimi ose përshtatshmëria e shpjegimit të veprimeve nga ATO ose TPB;



- garantimin se veprimet e ATO ose TPB janë në përputhje me politikat dhe procedurat e tyre; dhe
- garantimin që ATO ose TPB veprojnë në mënyrë të drejtë dhe transparente dhe i konsideron të gjitha informacionet relevante të ofruara, përfshirë revizionet dhe hetimet.

Në qoftë se nuk jeni të sigurtë nëse mund t'ju ndihmojme, ju lutemi të na kontaktoni.

Nëse nuk jemi në gjendje t'ju ndihmojmë në mënyrë direkte, do të bëjmë të pamundurën t'ju drejtojmë në zyrën e duhur apo organin e përshtatshëm për t'ju ndihmuar.



GPO Box 551, Sydney NSW 2001

Proçesi ankimor

Të bëni një ankesë pranë zyrës sonë, lexoni paragrafin “Si të na kontaktoni” (How to contact us).

Pasi keni bërë ankesën, një Investigator i IGTO do t`ju kontaktoj brënda një afati dy ditor ku do t`ju njoftoj për marrjen e ankesës suaj dhe do të diskutoj në lidhje me ankesën e bërë nga ju.

Nëse është e mundur, ne do t`ju ndihmojmë juve në mënyrë të drejtpërdrejtë për të adresuar ankesën tuaj.

Ne mund të këkojmë informacione shtesë nga ju, nga ATO apo TPB në mënyrë që të kuptojmë më mire ankesën tuaj si dhe të shikojmë sesi mund t`ju ndihmojmë sa më mire.

Ne do t`ju mbajmë në dijeni në lidhje me progresin tonë dhe ju sigurojmë afate kohore të hetimit tonë gjatë gjithë procesit.

Si të na kontaktoni



www.igt.gov.au



1300 44 88 29

(tarifa për thirje lokale)



GPO Box 551

Sydney NSW 2001

Nëse doni të bëni një ankesë në një gjuhë tjetër, përveç Anglishtes, telefononi Shërbimet e Përkthimeve (Translating and Interpreting Service - TIS) në **131 450**.

Nëse jeni me aftësi të kufizuara në dëgjim apo në të folur dhe keni mundësinë që të një përdorni një shtypshkronje elektromekanike (TTY) apo ndonjë pajisje moderne, telefononi në: **13 36 77**.

Nëse nuk e keni mundësinë e TTY apo të ndonjë pajisje moderne, telefononi Shërbimin Ndihmës të Transmetimit të Fjalëve (Speech to Speech Relay Service) në **1300 555 727**.